



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:261132

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05535351

CP.nr.842/13

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri dhe bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KRM P... SH.A. me seli në Prishtinë, rruga “..., kundër debitorit A.G nga Vushtrria rruga ..., lidhur me propozimin për përmbartim, jashtë seance më datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë propozimi për përmbartim i kreditorit KRM P... SH.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorit A.G nga Vushtrria rruga ..., për pagimin e borxhit në shumën prej 1,083.00 euro.

A r s y e t i m

Kreditori KRM P... SH.A. me seli në Prishtinë rruga ... me datë 05.03.2010, bazuar në dokumentin përmbartimor Aktgjykimin P.nr.587/05 të datës 07.10.2008, ka parashtruar propozim për ekzekutimin e borxhit në shumën prej 1,083.00 euro, kundër debitorit A.G nga Vushtrria rruga

Me konkluzionin e datës 20.03.2024, gjykata e ka urdhëruar kreditorin, që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit, gjykatës t’ia dërgoj dokumentin përmbartimor – Aktgjykimin P.nr.587/05 të datës 07.10.2008, në origjinal apo kopje të vërtetuar së bashku me vulën e

plotfuqishmërisë dhe atë të ekzekutueshmërisë, nën kërcënimin e pasojave procedurale nga neni 102 par.3 të LPK-së lidhur me nenin 38 të LPP-së.

Kreditore me datë 26.03.2024, e ka pranuar konkluzionin e gjykatës, e me parashtrësën e datës 28.03.2024, i ka dorëzuar gjykatës Propozimin për përmbarrim të datës 05.03.2010, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.1512/2012 të datës 02.10.2013 dhe Aktgjykimin P.nr.587/05 të datës 07.10.2008, në kopje të pavërtetuar, përkatësisht aktgjykimin e njëjtë të dorëzuar me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarrim, pra gjykatës nuk ia ka dorëzuar Aktgjykimin P.nr.587/05 të datës 07.10.2008, në origjinal apo kopje të vërtetuar së bashku me vulën e plotfuqishmërisë dhe atë të ekzekutueshmërisë.

Ligji për Procedurën Përmbarrimore, neni 22 par.1 përcakton se “ *Dokumente përmbarruese janë: 1.1. vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese. Neni 36 par.1 i këtij ligji përcakton se “Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri”, ndërsa neni 38 par.1 përcakton se “Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”.*

Marr parasysh dispozitat e lartcekura ligjore dhe meqenëse kreditore as pas konkluzionit të gjykatës, nuk e ka dorëzuar dokumentin përmbarrimor në origjinal apo kopje të vërtetuar së bashku me vulën e plotfuqishmërisë dhe atë të ekzekutueshmërisë, gjykata vendosi që propozimin për përmbarrim të kreditorit të hedhë poshtë.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 38 par.2 të LPP-së lidhur me nenin 102 par.3 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CP.nr.842/13, me datë 02.04.2024

Numri i lëndës: 2021:261132
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05535351

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.